



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Bulevardi "Zogu I", Tiranë.

Tel: +355 4 2259817, Fax: +355 4 2259822

www.kld.al

R A P O R T

MBI

VEPRIMTARINË E KËSHILLIT PËR VITIN 2013

Këshilli i Lartë i Drejtësisë si Institucion Kushtetues i kryesuar nga Presidenti i Republikës, dhe kompetent për të vendosur për transferimin e gjyqtarëve si dhe përgjegjësitë disiplinore të tyre, gjatë viti 2013 ka pasur një angazhim të drejtpërdrejtë në organizimin, në kontrollin e funksionimit të sistemit gjyqësor dhe gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, ku qytetarët tanë gjenden përditë për çështje të ndryshme në lidhje me drejtësinë. Është Kushtetuta ashtu dhe ligji nr.8811 datë 17.05.2011 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë" të cilat parashikojnë Këshillin si një Institucion, si një nga instrumentet kryesore të rëndësishëm të shtetit, për të analizuar sfidat me të cilat ndeshet sistemi ynë gjyqësor, për të konkluduar për objektivat dhe standardet që duhen arritur, si dhe për të ndërtuar dhe ndjekur atë proces që kërkohet edhe nga opinioni publik. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij Këshilli është përpjekur të jetë koherent me kërkesat e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe të planit të veprimit të saj, duke e konsideruar atë si një udhëzues të mirë në rrugëtimin e tij, për një gjyqësor të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm, eficient dhe të pakorruptuar.

Gjatë vitit 2013 Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka zhvilluar 23 mbledhje dhe konkretisht në datat 18.01.2013, 14.02.2013, 8.03.2013, 11.03.2013, 18.03.2013; 21.03.2013, 27.03.2013, 04.04.2013, 03.05.2013, 20.05.2013; 28.05.2013; 4.06.2013; 10.06.2013; 21.06.2013; 05.07.2013; 19.07.2013; 18.09.2013; 11.10.2013; 28.10.2013; 03.12.2013; 10.12.2013; 16.12.2013 dhe 20.12.2013.

Rendi i ditës në tërësi etij ka pasur për 140 çështje, dhe janë marrë rreth 340 vendime (342 vendime), vendime të cilat kanë qënë për çështje të rëndësishme.

- GJYKATAT ADMINISTRATIVE

Gjatë vitit 2013 Këshilli udhëhoqi të gjithë ecurinë e zhvillimit të funksionimit të gjykatave administrative mbështetur në e ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i vetëdijshëm në rëndësinë e ngritjes së Gjykatave Administrative, hartoi dhe miratoi procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë dhe të Apelit. Nën frymën e Presidentit të Republikës, Këshilli u obligua në rëndësinë e vendosjes së rregullave të qarta, për realizimin e një procedure sa më transparente për publikun, në përzgjedhjen e kandidatëve që do të

kryejnë funksionin e gjyqtarit në ato gjykata. Kjo vijoi me një procedurë të besueshme dhe për vetë trupën gjyqësore që ishte protagoniste e kandidimit, duke rritur besimin e tyre tek organi i 'qeverisjes' së sistemit gjyqësor.

Në zbatim të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Këshilli i Lartë i Drejtësisë miratoi vendimin nr.299/1, datë 30/11/2012 “Për procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe të Apelit. Bazuar në këtë vendim, u krijua Komisioni i Fondit të Pyetjeve dhe Komisioni Administrues i Testimit, të cilat u drejtuan nga anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe kishin përfaqësues nga Gjykata e Lartë, Shkolla e Magjistraturës dhe nga Fakulteti i Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës. Në vijim, KLD me Vendimin nr. 305 datë 08.03.2013 caktoi datat për zhvillimin e testimit seleksionues për gjyqtarë në gjykatën administrative të shkallës së parë dhe të gjykatës administrative të apelit dhe konkretisht datat 25–26 Mars 2013, në të cilat u zhvillua testimi seleksionues për kandidatët për gjyqtarë në Gjykatat Administrative të Apelit dhe për gjyqtarë në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë. Korrigjimi i rezultateve të testimit u krye për herë të parë me metodën elektronike “scantron”, që dha mundësinë e korrigjimit efektiv dhe transparent, brenda disa minutave nga përfundimi i testimit dhe në prani të vetë gjyqtarëve që konkuruan dhe të monitoruesve të akredituar. Procesi i zhvillimit të testimit seleksionues u mbikëqyr nga monitorues të pavarur ndërkombëtarë.

KLD përcaktoi me Vendimin nr. 329, datë 20.05.2013 “Për përcaktimin e procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtar në gjykatën administrative të apelit” kriteret e mëposhtme në përzgjedhjen e kandidatëve për në Gjykatën Administrative të Apelit:

- që gjyqtarët e apelit administrativ të përzgjidheshin ndërmjet kandidatëve të cilët, në provimin e testimit kishin marrë mbi 91 pikë nga 100 maksimale;
- që kandidatët të kishin vlerësimin profesional të tyre “Shumë Mirë” si dhe,
- marrja e informacionit nga ILDKP (Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive), nëse ka pasur problematika në procesin e deklarimit të pasurisë nga kandidatët.

Në përfundim të këtij procesi nga 21 kandidatë (*të cilët kishin marrë mbi 91 pikë*), me vendimin nr.324, datë 21.06.2013 “Për propozimet për emërimin e 7 (shtatë) gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit”, u përzgjedhën 7 gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Apelit. Nga gjyqtarët e përzgjedhur dhe që më pas u dekretuan nga Presidenti i Republikës, 5 prej tyre kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, ndërsa 2 të tjerët kanë mbi 17 vite punë si gjyqtarë.

Me vendimin nr.348, datë 05.07.2013 “Për disa propozime për emërimin e gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë, Presidentit të Republikës dhe mënyrën e plotësimit të vendeve në këto gjykata”, KLD përzgjodhi 16 gjyqtarë për në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, 3 gjyqtarë në Gjykatën Administrative Durrës, 2 gjyqtarë në Gjykatën Administrative Korçë dhe 1 gjyqtar në Gjykatën Administrative Shkodër.

Gjithashtu, Këshilli u angazhua për të realizuar plotësimin e vendeve vakat në gjykata nga gjyqtarët që i përkisnin listave të konkurentëve fitues të testimit, të cilët nuk u propozuan për emërim nga KLD. Brënda një afati të përcaktuar, me vendimin nr. 348, datë 05.07.2013, dhe nr.363 datë 18.09.2013, atyre iu dha mundësia të riparaqesin kërkesat e tyre pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për plotësimin e vendeve vakante për gjyqtarë në gjykatat administrative, të paplotësuara me gjyqtarë.

Rezultat i kësaj iniciative ishte emërimi i 5 (pesë) gjyqtarëve, respektivisht me vendimet nr.356 datë 19.07.2013 dhe nr.374 datë 11.10.2013 në gjykatat administrative të shkallës së parë. *(Me vendimin nr.408 datë 16.12.2013 është transferuar, me pëlqimin e tij, një gjyqtar një gjyqtar nga Gjykata administrative e shkallës së parë Durrës në gjykatën administrative të shkallës së parë Gjirokastër).*

Në mbledhjen plenare të datës 18.09.2013, me vendimin nr.362, Këshilli diskutoi dhe vendosi të japë pëlqimin për kërkesën e Ministrit të Drejtësisë, për t'i propozuar Presidentit të Republikës datën 4 Nëntor 2013, si datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative.

Aktualisht gjykatat administrative kanë filluar funksionimin e tyre rregullisht. Megjithë vështirësitë e hasura përse i përket kushteve dhe ambienteve të punës, mungesës së një administrate gjyqësore të mirëkualifikuar dhe mosmarrjes së masave për fillimin e funksionimit të ndihmësve ligjorë, jemi të sigurt se krijimi i gjykatave administrative, me miratimin e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, do të ndikojë në uljen e ngarkesës së gjykatave civile, për pasojë shpejtësi në gjykimin e çështjeve dhe rritje të cilësisë së gjykimeve jo vetëm në gjykatat administrative.

Për të rregulluar këtë situatë Këshilli me vendimet nr.407 datë 16.12.2013 “Për zhvillimin e testimit për plotësimin e vendeve vakant në gjykatat administrative të shkallës së parë” dhe vendimin nr.422 datë 20.12.2013 “Për caktimin e përfaqësuesit në Komisionin e Administrimit të Testimit dhe të datës së zhvillimit të tij” vendosi që të rihapë procedurën e testimit skonformë ligjit dhe procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr.299/1, datë 30.11.2013 “Për procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe të Apelit”. Testimi u zhvilluar në datë 3 shkurt 2014 dhe në të cilën mori pjesë vetëm një kandidat për në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Kandidati morri 95 pikë dhe i është propozuar Presidentit të Republikës për dekretim.

Gjithsesi procesi i plotësimit të vendeve vakant në këto gjykata vazhdon. Kemi 8 vende vakante në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë dhe përkatësisht: Durrësi (1 vend), Korçë (2 vende), Shkodër (2 vende), Gjirokastër (2 vende) dhe Vlorë (1 vend). Në këto vende vakante nuk ka patur kërkesa nga gjyqtarët që kanë marrë pjesë në testim dhe kanë fituar.

PROCESI I VLERËSIMIT TË GJYQTARËVE:

Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve që po aplikon së fundmi Këshilli i Lartë i Drejtësisë, synon të evidentojë vlerat profesionale të gjyqtarëve për efekt të karrierës së tyre, të identifikojë gjyqtarët që rezultojnë me pamjaftueshmëri profesionale dhe gjyqtarët me cilësi më të lartë. Gjithashtu, sistemi i vlerësimit profesional, përmes mekanizmave të tij, konstaton problematikat që ndeshen në gjykata gjatë verifikimit të veprimtarisë së tyre profesionale, si dhe identifikon nevojat për trajnim vazhdues të gjyqtarëve, në shërbim të rritjes së profesionalizmit të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, si dhe të kryetarëve të këtyre gjykatave, bazuar dhe realizuar në kriteret dhe procedurat e parashikuara në të.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka detyrimin kushtetues dhe përgjegjësinë institucionale të garantojnë besimin e gjykatësve të shkallës së parë dhe të apelit, në sistemin e vlerësimit dhe promovimit të karrierës së tyre.

Procesi i vlerësimit i veprimtarisë profesionale dhe etike e gjyqtarëve për vitet 2005 -2006 ka pasur një prioritet të posaçëm nga Këshilli gjatë vitit 2013, ka qenë një ndër arsyet më kryesoret, që ka shtuar madje edhe numrin e mbledhjeve plenare të zhvilluara të tij.

Numri total i gjyqtarëve të vlerësuar vetëm për vitin 2013 është 203. Aktualisht vlerësimi i gjyqtarëve për vitin 2005-2006 ka përfunduar për të gjithë gjyqtarët e sistemit si dhe ka filluar Vlerësimi profesional për vitet 2007-2009, duke u përfunduar tashmë ky vlerësim për 3 gjyqtarë. Vlerësimi i tyre është bërë me procedurë të përshpejtuar. Një rast i përket procedurës së emërimit të Kryetarit të Gjykatës, ndërsa 2 rastet e tjera i përkasin rivlerësimit për shkak të vlerësimit “Pranueshëm” të gjyqtarëve në raundin e parë 2005-2006 referuar nenit 13.4 të ligjit për pushtetin gjyqësor, “...gjyqtarët e vlerësuar “pranueshëm” duhet të rivlerësohen brenda 1 viti”.

Gjithashtu Këshilli mbështetur në Vendimin nr.261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, me vendimin nr.413 datë 16.12.2013 ka miratuar Programin “Mbi përcaktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve që do t’i nënshtrohen vlerësimit etiko-profesional për periudhën 2007-2009 përgjatë vitit 2014” duke filluar kështu mbledhjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e procesit të vlerësimit të gjyqtarëve, për 3 vitet konkretisht për periudhën 2007-2008-2009.

Procesi i vlerësimit, është aplikuar për herë të parë në historinë e sistemit gjyqësor shqiptar. Ky proces është përkrahur dhe është përshëndetur nga partnerët ndërkombëtarë duke u konsideruar si një hap cilësor në cuarjen përpara të reformës në sistemin e drejtësisë. Vlerësimi ka dhënë një impakt të jashtëzakonshëm tek procesi i promovimit të gjyqtarëve. Asnjë gjyqtar nuk është promovuar pa u vlerësuar më parë, dhe asnjë konkurim nuk është bërë pa u pikëzuar paraprakisht të gjithë kandidatët konkuroes, pikërisht bazuar në vlerësimin etiko-profesional të tyre. Sistemi i Vlerësimit i përfunduar tashmë ka gjeneruar edhe Listën e Përgjithshme të Renditjes së Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, listë e cila u përfundua dhe u publikua për herë të parë në muajin dhjetor të vitit 2013.

EMËRIME, TRANSFERIME DHE PROMOVIME

Pjesë e konsiderueshme e punës së Këshillit gjatë vitit 2013 ka qenë zbatimi i Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 7818 datë 16.11.2012 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative”. Ky dekret parashikon një reformim total të strukturës së sistemit, parashikon ndryshime në numrin e gjyqtarëve në shumë gjykata, shtimin apo pakësim të numrit duke ngarkuar kështu Këshillin me një përgjegjësi të madhe në miradministrimin e të gjithë këtij procesi.

Këshilli gjatë vitit që kaloi në të gjithë vendimarrjen e tij ka garantuar integritetin profesional dhe njerëzor të çdo gjykatësi të këtij vendi, duke qenë stoik në vendimarrje se nuk do të bënte asnjë promovim apo transferim gjyqtari pa bërë më parë vlerësimin profesional të tyre. Në të gjithë vendimarrjen e tij ka treguar vullnetin për të promovuar vetëm më të mirët e sistemit gjyqësor, pasi çdo transferim apo promovim është realizuar vetëm për ata gjyqtarë të vlerësuar profesionalisht “Shumë mirë”, ashtu dhe duke iu nënshtuar rregullave të vendimit nr.274/2 datë 16.02.2011 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Kandidatëve për Gjyqtarë”, të ndryshuar dhe rregullave të Vendimit nr.269/2, datë 27.09.2010 “Për rregullat e hollësishme për sistemin e pikëzimit të detyrueshëm për zbatim, në rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për plotësimin e vendeve vakante në gjykatat e apelit dhe në gjykatat për krime të rënda”, të ndryshuar. Këto vendime përcaktojnë kriteret në shqyrtimin e kërkesave si: aftësitë në ushtrimin e profesionit, vjetërsia, si dhe rrethana të

tjera që lidhen me vendin e ushtrimit të detyrës apo kushteve familjare. Të dy këto vendime janë hartuar më asistencën e Misionit Euralius III.

Në përbërje të Komisionit të shqyrtimit të kandidaturave për gjyqtarë ishin Zëvendëskryetari i Këshillit, 3 anëtarë të tij (automatikisht 3 anëtarët e grupit të pikëzimit), Kryeinspektori i KLD-së dhe një përfaqësues i MD-së.

Në vitin 2013 për herë të parë Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka votuar për transferime apo promovime gjyqtarësh, duke u bazuar vetëm në listat e renditjes me pikë të gjyqtarët konkurrentë, të cilët ishin të pikëzuar nga një komision i posaçëm, çka rriti shumë cilësinë e dhe standardin e përzgjedhjes së kandidatëve. Gjithsesi Këshilli do të ketë në axhendën e punës së tij përsosjen e mëtejshme të këtyre vendimeve mbi pikëzimin e gjyqtarëve, të kritereve që përmbajnë për të bërë sa më të mundur eliminimin e subjektivizmit në momentin e votimit nga secili anëtar.

Gjithashtu Këshilli i Lartë i Drejtësisë u angazhua për realizimin e promovimeve dhe transferimeve, vetëm në bazë të vlerësimit profesional të gjyqtarëve, angazhim i cili është konkretizuar në të gjitha vendimmarrjet respektive. Kështu, u realizua vlerësimi profesional për të gjithë gjyqtarët që kishin kandiduar për promovim dhe vetëm ato që janë vlerësuar “Shumë mirë” nga Këshilli është bërë promovimi dhe transferimi i tyre. Konkretisht më poshtë vendimet:

- 3 gjyqtarëve në **Gjykatën e Apelit Shkodër**, (vendim nr.320 datë 03.05.2013)
- 6 gjyqtarëve në **Gjykatën e Apelit Tiranë**, (vendim nr.349 datë 05.07.2013)
- 4 gjyqtarëve në **Gjykatën e Apelit Vlorë**, (vendim nr.375 datë 11.10.2013)
- 3 gjyqtarëve në **Gjykatën e Apelit Durrës**, (vendim nr.376 datë 11.10.2013)
- 1 gjyqtarit në **Gjykatën e Apelit Korçë** (vendim nr.15 datë 24.02.2014)
- 1 gjyqtarit në **Gjykatën e Apelit Gjirokastrë**, (vendim nr.15 datë 24.02.2014)

Këshilli me vendimin nr.419, datë 20.12.2013 “Për transferim gjyqtarësh në Gjykatën e shkallës së Parë Tiranë” vendosi të transferojë rreth 13 gjyqtarë, paraprirë kjo vendimmarrje nga vendim nr.409, datë 16.12.2013 i cili përcaktoi se plotësimi i 13 (trembëdhjetë) vendeve vakante në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë të bëhet me gjyqtarë nga gjykatat e rretheve gjyqësore të shkallës së parë, numri i gjyqtarëve në të cilat, është mbi organikë referuar Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 7818, datë 16.11.2012 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative”.

Gjithashtu gjatë vitit 2013 Këshilli ka ndjekur me përparësi edhe emërimin në funksionet drejtues në disa Gjykata të vendit duke eliminuar tentuar eliminimin e kësaj problematike të mosëmërimit të tyre. Prandaj mori prioritet edhe për këtë qëllim vlerësimi i të gjithë kandidatëve të cilët kishin paraqitur kërkesën për pozicionin e kryetarit të gjykatës.

Në këtë proces Këshilli është mbështetur në të ligjin nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Vendimin Nr.227/2, datë 28.03.2008, “Për funksionin drejtues në gjykata” të këshillit, duke garatuar një procedurë tërësisht transparente dhe konkurruese. Në këtë proces është kërkuar për të gjithë kandidatët informacion nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurisë për pasjen ose jo, të ndonjë problematike në deklarimin e pasurisë apo të konfliktit të interesit, është kërkuar mendimi dhe

opinionin nga dhomat e avokatisë dhe prokuroritë e rretheve përkatëse, mbi kandidatët të cilët kërkojnë të ushtrojnë funksionin drejtues në gjykatë.

Nga gjithsej 30 gjykata, duke mos përfshirë këtu gjykatat administrative të sapokrijuara, vetëm 2 kryetarë gjykate ishin emëruar deri në muajin nëntor të vitit 2012, dhe konkretisht {Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, (vendimin nr. 282 datë 16.12.2011) dhe Kryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë (vendim nr.285 datë 13.02.2012)}, të gjithë 28 gjykatat e tjera, nuk kishin të emëruar Funksionin Drejtues të Kryetarit të Gjykatës. Menjëherë Këshilli i dha përparësinë e duhur emërimit të kryetarëve duke emëruar deri në këtë moment edhe 12 kryetarë në këto gjykata. Aktualisht janë në krye të detyrës, të emëruar:

- 7 kryetarë gjykate, nga 23 gjykata në shkallë e parë civile dhe Shk. Parë Kr.Rënda,
- 6 kryetarë gjykate, nga 7 Gjykata Apeli Civil dhe Apelit Kr.Rënda,
- 6 gjykata administrative shkallë e parë (në proces)
- 1 kryetar gjykate, nga 1 Gjykate Apeli Administrativ

Pra, janë emëruar ne Funksionin Drejtues të **Kryetarit të gjykatës** gjithsej, 14 kryetarë gjykate (7 kryetarë gjykate të shkallës së parë, 7 kryetarë të gjykatave të apelit (përfshirë edhe apeli administrativ.)

Të gjithë kryetarët e emëruar dhe për të gjithë kandidatët u realizuar vlerësimi profesional.

- | | |
|--|----------------------------------|
| 1. Gjykata e Apelit Tiranë | (vendim nr.285 datë 13.02.2012) |
| 2. Gjykata e Apelit Shkodër, | (vendim nr. 3 datë 17.01.2014) |
| 3. Gjykata e Apelit Vlorë | (vendim nr. 4 datë 17.01.2014) |
| 4. Gjykata e Apelit Korçë | (vendim nr. 5 datë 17.01.2014) |
| 5. Gjykata e Apelit Gjirokastër | (vendim nr. 6 datë 17.01.2014) |
| 6. Gjykata e Apelit Durrës | (vendim nr. 33 datë 11.04.2014) |
| 7. Gjykata Administrative e Apelit | (vendim nr. 12 datë 24.12.2014) |
| 8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet | (vendim nr.282 datë 16.12.2011) |
| 9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë | (vendim nr.303, datë 18.01.2013) |
| 10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan | (vendim nr.297 datë 15.11.2012) |
| 11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat | (vendim nr.371 datë 11.10.2013) |
| 12. Gjykata e Rrethit Pogradec | (vendim nr.372 datë 11.10.2013) |
| 13. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër | (vendim nr.381 datë 28.10.2013) |
| 14. Gjykata e Rrethit Dibër | (vendim nr. 34 datë 11.04.2014) |

Gjate vitit 2013 mbështetur në nenin 4.1 dhe 7.2 të vendimin Nr.227/2, datë 28.03.2008, “Për funksionin drejtues ne gjykata” për shak të situatës emergjente si pasojë e transferimeve të kryetarëve të gjykatave ka realizuar edhe delegimin e gjyqtarëve të po asaj gjykate për të kryer përkohësisht detyrën e kryetarit të gjykatës dhe konkretisht:

- Me vendimin nr. 392 datë 28.10.2013 është deleguar për të kryer përkohësisht kryetari në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, aktualisht është emëruar Kryetari i Gjykatës.
- Me vendimin nr.358 datë 19.07.2013 është deleguar për të kryer përkohësisht kryetari në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës;
- Me vendimin nr. 420 datë 20.12.2013 është deleguar për të kryer përkohësisht kryetari në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë;
- Me vendimin nr.332 datë 20.05.2013 është deleguar për të kryer përkohësisht kryetari në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë;

- Me vendimin nr.403 datë 03.12.2013 është deleguar për të kryer përkohësisht kryetari në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë;
- Me vendimin Nr.390 datë 28.10.2013 është deleguar për të kryer përkohësisht kryetari në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër; (Deleguar më parë me vendimin nr. 348, datë 05.07.2013, gjyqtari Gentian Medja, i cili u transferua në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë).
- Me vendimin nr. 391 datë 28.10.2013 është deleguar për të kryer përkohësisht kryetari në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë;

Gjithashtu nëpërmjet 7 vendimeve (nr.383; nr.384; nr.385; nr.386; nr.387; nr.388; dhe nr.389) të datë 28.10.2013 Këshilli i Lartë i Drejtësisë delegoi gjyqtarët për të kryer përkohësisht detyrën e Kryetarit të Gjykatës në gjykatat administrative të shkallës së parë të sapokrijuar.

ANALIZAT VJETORE NË GJYKATA

Me vendimin nr.303/2, datë 18.01.2013 Këshilli miratoi grafikun e zhvillimit të analizave vjetore të punës së gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të apelit.

Procesi i zhvillimit të analizave vjetore ka filluar në datë 18 shkurt dhe ka përfunduar në datë 13 mars 2013. Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka qenë prezent në të gjitha analizat vjetore të tridhjetë gjykatave të shkallës parë dhe të apelit. Gjithashtu në këto analiza morrën pjesë në mënyrë të alternuar dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përfaqësues të prokurorive të rretheve si edhe përfaqësues të dhomave përkatëse të avokatisë sipas rretheve gjyqësore në të cilat bëhej analiza vjetore.

Në tërësinë e tyre të gjitha këto analiza u zhvilluan nën praninë e medias si një mesazh dhe një qasje unike e mjaft domethënëse për t'u larguar tej analizave vjetore standarte dhe monotone pa asnjë dobi dhe efektivitet.

Kryesisht analiza mbështetej në punën e bërë nga gjykatat në zbatim të Kushtetutës, të Kodeve në fuqi, të legjislacionit mbi funksionimin e pushtetit gjyqësor si dhe mbi vendime të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (vendimit “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore; Vendimit nr.227/2 datë 28.03.2008 “Për funksionin drejtues në gjykata”; vendimit nr.234/4 datë 08.09.2008 “Mbi delegimet e gjyqtarëve për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore”; vendimit nr.238/1/a datë 24.12.2008 “Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore”; vendimit nr.238/1/b datë 24.12.2008 “Për solemnitetin e gjykimit e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit”; etj.).

Të gjitha analizat u zhvilluan nën frymën e shkëmbimit të ideve dhe përvojës ndërmjet gjyqtarëve përfaqësuesit e KLD, me njëri-tjetrin, me kryetarin e gjykatës, ndërmjet gjyqtarëve dhe përfaqësuesve të prokurorisë apo të dhomës së avokatisë, duke dhënë theksin tek problematika e çështjeve apo dhe tek krijimi i standardeve të njëjta në dhënien e drejtësisë.

Në analizat e kryera u konstatua se përgjithësisht gjykatat në vendin tonë vazhdojnë të kenë disa probleme mjaft të rëndësishme dhe eliminimi i tyre përbën sfidën e ardhme për sistemin tonë të drejtësisë pasi kanë lidhje të drejtpërdrejtë me publikun, qytetarin, me dhënien e drejtësisë.

LISTA E PËRHERSHME E RËNDITJES SË GJYQTARËVE, PËRDITËSIMI I SAJ.

Gjatë vitit 2013 u bë e mundur që për herë të parë, në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, të përgatitet Lista e Përhershme e Renditjes së gjyqtarëve, kërkesë ligjore kjo e pazbatuar që nga hyrja në fuqi të ligjit në vitin 2008.

Kjo listë është përgatit, mbështetur në:

- ❖ Ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 14,
- ❖ Vendimi nr. 269/2, datë 27.09.2010 “Për rregullat e hollësishme për sistemin e pikëzimit të detyrueshëm për zbatim, në rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për plotësimin e vendeve vakante në gjykatat e apelit dhe gjykatat e krimeve të rënda”, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,
- ❖ Në të dhënat personale dhe profesionale, sipas dokumentacionit të ndodhur në fashikullin e secilit gjyqtar që disponohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore, pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Lista e përhershme e renditjes së gjyqtarëve tashmë ndodhet e publikuar në faqen e Web-it, të KLD dhe do të përditsohet vazhdimisht nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Komisionin e Pikëzimit.

REGJISTRI I GJYQTARËVE

Edhe Regjistri i Gjyqtarëve është përgatitur gjatë vitit 2013, në të janë pasqyruar të plota të dhënat për çdo gjyqtar, si gjeneralitetet, edukimi akademik, kualifikime e trajnime, veprimtaritë shkencore, koha e emërimit në gjyqsor dhe lëvizjet brenda tij, vjetërsia në gjyqsor, vlerësimi profesional dhe masat disiplinore nëse ka.

Ky regjistër është përgatitur bazuar në :

-Ligj nr.9877, datë 18.2.2008 Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë neni 19 për regjistrin e gjyqtarëve.

-Vendimit nr. 177/2, datë 16.6.2005, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi evidentimin e të dhënave për gjyqtarët”.

-Të dhënat e pasqyruara në këtë regjistër janë marrë nga dosja personale e secilit gjyqtar që disponohet në Sektorin e Burimeve Njerëzore, të dhëna të cilat janë rifreskuar po gjatë vitit 2013.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë gjatë kësaj periudhe, një vjeçare ka qenë monitorues i kujdesshëm dhe penalizues i ashpër në të gjitha rastet, e konstatimeve të veprimtarive të parregullta apo të veprimtarive në kundërshtim me ligjin. Ka qenë kategorik në vendimmarrje, ka qenë në unanimitet duke hapur rrugën dhe më pas ndëshkuar gjyqtarë, axhenda e të cilëve nuk ishte dhënia e drejtësisë. Janë realizuar disa inspektime dhe kemi marrë mjaft masa disiplinore gjatë kësaj periudhe ndaj gjyqtarëve.

Kërkesa për masat disiplinore të shqyrtuara për vitin 2013

| Nr. | GJYQTARI/JA | GJYKATA | MASA DISIPLINORE | VENDIM KLD |
|-----|-------------|--|--|-----------------------------|
| 1. | Dh. B. | Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës | Rrëzimi i kërkesës për masën disiplinore ‘vërejtje’ | Nr. 303/14, datë 18.01.2013 |
| 2. | Xh. K. | Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan | ‘Shkarkim nga detyra’ | Nr. 306, datë 08.03.2013 |
| 3. | F.H M.K | Gjykata e Rr.Gjyq. Durrës Gjykata e Rr.Gjyq. Durrës | Pezullimi i procedimit disiplinor për shkak se çështjet e inspektuara janë në shqyrtim në Gjykatën e Lartë | Nr.304/5, datë 14.02.2013 |

| | | | | |
|-----------|-------------------------------|---|---|-----------------------------------|
| | R.K | Gjykata e Rr.Gjyq. Mat | | |
| 4. | F.H. | Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës | Procedimi i pezulluar u pushua me kërkesë të Ministrit për shkak se Gjykata e Lartë la në fuqi vendimmarrjen e gjyqtarës | Nr.354 Datë 19.07.2013 |
| 5. | M.K. R.K | Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat | Pezullimi i procedimit disiplinor vijon për shkak se çështjet e inspektuara janë në shqyrtim në Gjykatën e Lartë | Nr.354 Datë 19.07.2013 |

Siç konstatohet gjatë këtij viti Këshilli ka shqyrtuar raste për procedim disiplinor ndaj gjyqtarëve ku rasti më tipik i saj është shkarkimi nga detyra e gjyqtarit Xh.K. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr.306, datë 08.03.2013. Shkarkimi i tij erdhi si pasojë e shqetësimeve të përsëritura të paraqitura në KLD nga subjekte të ndryshme dhe për të cilën Këshilli me vendimin Nr.293/9, datë 07.08.2012, vendosi inspektimin e **veprimtarisë gjyqësore** të këtij gjyqtari për periudhën 01.01.2011 - 31.07.2012. Pas realizimit të procedimit disiplinor, Këshilli vendosi shkarkimin e gjyqtarit për shkelje të dispozitave urdhëuese proceduriale, të cilat kanë sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim, dhe kanë diskredituar rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit.

Gjithashtu Këshilli në muajin dhjetor të vitit 2013 trajtoi në një mbledhje të jashtëzakonshme të datës 3 dhjetor rastin e publikimit të disa pamjeve në të cilat punonjës të administratës gjyqësore kryenin afëra korruptive, duke pasur dyshimin e arsyeshëm se edhe kryetari i asaj gjykate, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, ishte përfshirë në këtë aferë korruptive. Pas shqyrtimit të kësaj situate me Vendimin nr.402 datë 03.2013 liroi fillimisht nga ushtrimi i funksionit drejtues të Kryetarit e Gjykatës Sh. Ll. dhe me vendimin nr.404 datë 03.12.2013 vendosi inspektimin e veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, dhe të administratës gjyqësore të asaj gjykate, lidhur me ankesën e bërë publike nga televizioni, për shkelje të etikës dhe mosrespektim formal të ligjit, në shqyrtimin e çështjeve të përmendura në këtë televizion. Për kryerjen e këtij inspektimi u ngarkua Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe ai i Ministrisë së Drejtësisë.

Në vijim të trajtimit të këtij rasti në mbledhjen e jashtëzakonshme të datës 10 dhjetor 2013, me vendimin nr.405 vendosi të autorizojë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të shqyrtojë kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj një gjyqtarit dhe në mbledhjen e datës 16 dhjetor 2013, me vendimin nr.406 vendosi të pezullojë nga ushtrimi i detyrës gjyqtarin në fjalë, derisa të merret vendim i formës së prerë për çështjen për të cilën është nisur procedimi penal ndaj tij.

Raportin “Mbi inspektimin e përbashkët të veprimtarisë së gjyqtarit Sh. Ll. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë mbi ngjarjen e transmetuar në televizion”, i përgatitur nga Inspektorati i Këshillit dhe Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, mbështetur në vendimin nr.404 datë 03.12.2013, u trajtua në mbledhjen e Këshillit dhe në

përfundim u vendos që materiali t'i dërgohej Ministrit të Drejtësisë për të iniciuar procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit si edhe disa institucioneve të tjera, sipas parashikimeve në rekomandimet e tij.

KËRKESAT E KLD PËR INICIIM PROCEDIMI 2013

Në vitin kalendarik 2013, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë i janë dërguar 24 relacione Ministrit të Drejtësisë për të vlerësuar mundësinë eventuale të inicimit të procedimeve disiplinore për 16 gjyqtarë.

Në total për vitin 2013 dhe deri tani KLD i ka dërguar Ministrit të Drejtësisë 40 kërkesa për iniciim procedimi disiplinor për 24 gjyqtarë.

REALIZIMI I INSPEKTIMEVE TEMATIKE

Ka qenë objekt i rëndësishëm i vendimmarrjes së Këshillit, duke konsideruar rritjen e përgjegjshmërisë, një element të rëndësishëm të prioritetëve tona.

- ❖ Me vendimin Nr. 297/9, datë 15.11.2012, duke vlerësuar tepër shqetësuese përmasat në rritje të dhunës në familje, u vendos realizimi i inspektimit tematik në gjykatat e shkallëve të para dhe të apelit, në lidhje me shqyrtimin e çështjeve me objekt **marrjen e masave kundër dhunës në familje**. Inspektimi do përqendrohet në evidentimin e respektimit të afateve ligjore, në shqyrtimin e kërkesave me objekt “Lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes”, “Lëshimin e urdhrit të mbrojtjes”, në gjykimet me objekt caktimin e masave të sigurimit personal, për të dyshuarit për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, si edhe ecurinë e gjykimet në gjykatat më të larta, për çështje të kësaj natyre.
Raporti ka përfunduar nga inspektorati i Këshillit dhe pritet të shqyrtohet në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- ❖ Me vendimin Nr. 307, datë 08.03.2013, në adresim të disa shqetësimeve të identifikuara gjatë analizës së punës vjetore në gjykata për vitin 2012, u vendos inspektimi i veprimtarisë së kryetarëve të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të apelit, në lidhje me **procedurën e ndarjes së çështjeve me short**, si dhe në lidhje **me caktimin e gjyqtarëve në seksione**.
Materialet janë mbledhur dhe po përpunohet Raportit.
- ❖ Në mbledhjen e datës 18.09.2013, me vendimin nr. 364 Këshilli ngarkoi inspektoratin e tij, që të inspektojë ushtrimin e **veprimtarisë së mësimdhënies nga gjyqtarët** për vitin akademik 2012-2013. Pritet të fillojë së shpejti pas hartimit të një plani pune nga Inspektorati dhe paraqitja e raportit të detajuar në të cilën të pasqyrohet respektimi i rregullave të përcaktuara nga Këshilli për mësimdhënie nga gjyqtarët.
Raporti ka përfunduar nga inspektorati i Këshillit dhe pritet të shqyrtohet në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- ❖ Me vendimin nr. 404 datë 03.12.2013, është vendosur inspektimi i përbashkët, nga inspektorati i KLD dhe i MD, i veprimtarisë së gjyqtarit Sh. Ll. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë mbi ngjarjen e transmetuar në televizionin Top Channel. Siç raportuam më sipër ky inspektim ka përfunduar është

vendosur nga Këshilli t'i dërgohej Ministrit të Drejtësisë për të iniciuar procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit si dhe ti dërgohej dhe disa institucioneve të tjera, sipas parashikimeve në rekomandimet e tij.

VENDIMARRJE TË TJERA TË RËNDËSISHME

Në kuadër të rritjes së transparencës së punës së institucionit, Këshilli miratoi vendimin nr. 319, datë 05.03.2013 "Për kriteret dhe mënyrën e delegimit të gjyqtarëve në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore" (duke shfuqizuar vendimin e mëparshëm të vitit 2008), i cili përcakton kriteret objektive për delegimin e gjyqtarëve, për të shmangur çdo pengesë në dhënien e drejtësisë në kohën e duhur paralelisht me respektimin e parimit të gjyqtarit natyral. Ky akt është hartuar me asistencën e Misionit Euralius III.

Një zhvillim i ri lidhet me një vendim të KLD nr.346 date 05.07.2013 e cila ka ngritur një grup pune për studimin dhe hartimin projekt-aktit për funksionimin e komisioneve të përhershme pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë. KLD beson se ngritja e komisioneve do të rrisë mirëfunksionimin e saj, cilësinë e vendimmarrjes dhe transparencën. Ngritja e tyre do të bëhet duke marrë në konsideratë rekomandimet e Projektit të Binjakëzimit "Mbështetje për Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Inspektoratin e tij" të Komisionit European, rekomandimet e Misionit EURALIUS III, si dhe në praktikën më të mirë të organizimit dhe funksionimit të këshillave të lartë të drejtësisë në vendet europiane.

Lidhur me organizimin e brendshëm, me vendimin nr.344 datë 05.07.2013 "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë" u miratua kjo rregullore, e cila synon rritjen e mirëfunksionimit dhe të transparencës së veprimtarisë së administratës së KLD-së në raport me kërkesat e publikut dhe me rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së vetë Këshillit.

Gjatë vitit 2013, mbështetur në Vendimin nr. 278/2, datë 19.07.2011 "Për veprimtarinë akademike të gjyqtarëve", të Këshillit janë shqyrtuar dhe akorduar Leje mësimdhënie për 16 gjyqtarë. Nisur nga numri i madh i gjyqtarëve të cilët kanë marrë pjesë dhe kanë ushtruar mësimdhënie dhe pasojave që mund të sjellë kjo në ushtrimin e detyrës parësore, të gjyqtarit, Këshilli ka ngarkuar inspektoratin të paraqesë në Këshill një raport të detajuar në të cilën të pasqyrohet veprimtaria e mësimdhënies së gjyqtarëve në këndvështrimin e respektimit të rregullave të përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në Vendimin e tij nr. 278/2, datë 19.07.2011 "Për veprimtarinë akademike të gjyqtarëve". Raporti duhet të evidentojë pasojat që veprimtaria akademike mund të ketë sjellë në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, shpërblimi i marrë në raport me pagën e gjyqtarit, si dhe rastet në të cilat ushtrohet mësimdhënia pa autorizim të Këshillit.

BASHKËPUNIMI ME SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

Duke mbajtur parasysh përcaktimet në ligjin Nr. 8136, datë 31.07.1996 "Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në mbledhjet e tij të organizuara gjatë vitit 2013, ka trajtuar çështje të ndryshme që lidhen me veprimtarinë e Shkollës së Magjistraturës, duke vënë theksin sipas problematikave përkatëse, e konkretisht:

Në mbledhjen e KLD, datë 18.01.2013 janë trajtuar në Rendin e Ditës, çështje të ndryshme për nga problematikën, si:

- Miratimi i propozimit të Drejtores së Shkollës së Magjistraturës, mbi listat me emrat e gjyqtarëve pjesëmarrës në programin e Trajnimit Vazhdues, për periudhën 2012-2013, në Shkollën e Magjistraturës (vendimi 303/4, dt

18.01.2013), si dhe me vendimin nr.410, datë 16.12.2013 miratoi Programin e Trajnimit Vazhdues, për periudhën 2013-2014 të Shkollës së Magjistraturës.

- Shqyrtimi përjashtimisht në këtë mbledhje i Vendimit nr.1, datë 15.01.2013, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, për çështje që lidheshin me mbarëvajtjen e procesit të testimit seleksionues të kandidatëve për gjyqtar në gjykatat administrative (vendimi 303/12, dt 18.01.2013).

Në mbledhjen e KLD, datë 14.02.2013 u trajtuan përsëri probleme organizimi, në kuadër të mbarëvajtjes së procesit të testimit seleksionues të kandidatëve për gjyqtar në gjykatat administrative, proces ky, në të cilin Shkolla e Magjistraturës kishte dhe ka një rol shumë të rëndësishëm (304/3, dt 14.02.2013). *(Trajtimi i çështjeve të lidhura me këtë proces u realizua edhe në mbledhje të tjera pasuese të KLD).*

Gjithashtu KLD pjesë të veprimtarisë së tij në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës ka edhe caktimin e vendeve vakant për për kandidatët për magjistratë, profili gjyqtar, përvitin akademik vijues. Për vitin akademik 2013-2014, Këshilli ka përcaktuar 8 (tetë) vende vakante me vendimin nr.328, dt 20.05.2013.

Në mbledhjen e KLD, dt 05.07.2013, KLD vendosi të caktojë një gjyqtar si anëtar i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Gjatë vitit 2013 Këshilli vlerësoi edhe propozimin e Bordit të Shkollës së Magjistraturës për emërimin e Drejtorit të kësaj shkolle, dhe referuar këtij propozimi Këshilli emëroi Zotin Neshat Fana, në postin e Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës (vendimi nr.359, dt 19.07.2013)

Në mbledhjen e datës 20.01.2014 KLD vendosi të propozojë për emërim përfundimtar nëpër gjykata të rretheve gjyqësore, të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që kanë mbaruar vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës në vitet akademike 2011-2012 dhe 2012-2013. Procesi i emërimit të këtyre magjistratëve u parapri fillimisht caktimin e vendeve në dispozicion të tyre dhe pas marrjes së kërkesave nga vetë magjistratët Këshilli konkludoi me përzgjedhjen përfundimtare.

Gjithashtu gjatë vitit 2013 është miratuar Programi i Trajnimit Vazhdues për periudhën 2013-2014 të Shkollës së Magjistraturës (vendimi nr.410, dt 16.12.2013) si dhe është bërë dhe emërimi i i përkohshëm (stazhier) të magjistratëve që vazhdojnë këtë shkollë.

MARRËDHËNIET ME INSPEKTORATIN

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka qenë i angazhuar në rritjen e efektivitetit dhe mirëfunksionimit të punës së Inspektoratit të KLD duke marrë mendime e propozime nga partnerët tanë për t'ju referuar praktikave më të mira të standardeve evropiane. Një sistem gjyqësor i përgjegjshëm është gjithashtu një prioritet kyç i punës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Realizimi i këtij prioriteti bazohet kryesisht në zhvillimin e inspektimeve dhe procedimeve disiplinore të gjyqtarëve.

Inspektorati pranë KLD ka objekt të veprimtarisë së tij: Mbledhjen e te dhënave rreth veprimtarisë së gjykatave dhe gjyqtarëve, nëpërmjet verifikimit të ankesave, inspektimit të gjykatave, inspektimit të gjyqtarëve dhe vlerësimit të aftësive të tyre profesionale, mbi të cilat Këshilli i Lartë i Drejtësisë zhvillon përgjegjësitë ligjore të tij. Gjithashtu, Inspektorati konstaton ekzistencën e shkeljeve disiplinore apo të rasteve të shkarkimit të gjyqtarëve dhe dokumentimi i tyre, nëpërmjet verifikimeve dhe inspektimeve, mbi të cilat nga autoriteti përgjegjës mund të fillohet procedimi disiplinor i gjyqtarëve.

Rritja e numrit të inspektorëve: Duke marrë në konsideratë punën voluminoze dhe esenciale që duhet të realizojë Inspektorati, në zbatim të rekomandimeve të Raport Progresit të BE-së 2012, me vendimin nr. 302/2 datë 20.12.2012, është miratuar organika e re e KLD-së, ku ndër të tjera u rrit me 3 (tre) numri inspektorëve, duke shkuar në total në 16 Inspektorë (1 Kryeinspektor dhe 15 inspektorë) pa rritur numrin e administratës.

Rritja e numrit të inspektorëve synon, të rrisë cilësinë e punës, duke eliminuar mbingarkesën. Inspektorati me propozim të Kryeinspektorit dhe miratim të Zëvendëskryetarit të KLD (me urdhërin nr.8 datë 19.04.2013), është ndarë në dy Seksione të veçanta, konkretisht Seksioni i Inspektimit dhe verifikimit të ankesave dhe Seksioni i Vlerësimit Profesional dhe Etik të gjyqtarëve. Rritja e numrit dhe organizimi në seksione të ndara ka për qëllim përmbushjen e funksioneve nga Inspektorati me efikasitet dhe profesionalizëm, ndryshim ky që do të influencojë në shpejtësinë dhe cilësinë e punës së Inspektoratit, përballimin e ngarkesës së punës nga procesi i vlerësimit të gjyqtarëve dhe procesi i kontrollit në gjykata.

Gjithashtu është ulur numri i drejtorive të administratës së Këshillit nga 4 (katër) në 2 (dy), si edhe ka shtuar funksionin e ri të “Sekretarit të Përgjithshëm”. Ristrukturimi pritet të rrisë efikasitetin, në cilësi dhe shpejtësi, në përmbushjen e funksioneve të KLD-së dhe vjen në përputhje me sugjerimin e Projektit të Binjakëzimit të Komisionit Evropian, si dhe nga Misioni Euralius III.

MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT ME MD DHE AP:

Këshilli i Lartë i Drejtësisë së bashku me Ministrinë së Drejtësisë dhe Avokatin e Popullit, nën asistencën e Misionit EURALIUS III, nënshkruan memorandumin e bashkëpunimit “Për referimin e rasteve dhe masave administrative ndaj funksionarëve të drejtësisë kur konstatohen shkelje të ligjit”, më 12 shkurt 2013. Qëllimi i memorandumit është konsolidimi i bashkëpunimit ndërmjet Palëve, për referimin e rasteve dhe masave administrative ndaj funksionarëve të drejtësisë, sipas kompetencës të secilës palë, kur konstatohen shkelje të ligjit.

CËSHTJE GJYQËSORE

Gjatë vitit 2013 janë ndjekur nga afër disa çështje gjyqësore në të cilat Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka qënë në cilësinë e palës së “paditur”, çështje që kanë të bëjnë me ankim ndaj masave disiplinore të marra nga KLD, çështje që kanë të bëjnë me ankime ndaj vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve, etj.

Me vendimin nr.323 datë 0305.2013, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mbështetur në ligjin nr. 8811 datë 17.05.2001 “Mbi autorizimin e përfaqësimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në gjykatë” autorizoi Zëvendëskryetarin e KLD që të caktojë sipas rastit personat të cilët do të përfaqësojnë Këshillin në gjykata.

Konkretisht gjatë vitit 2013 janë ndjekur nga afër çështjet:

- ✓ Çështja me palë paditëse Kreshnik Spahiu, i paditur Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dhe objekt “Shfuqizim akti administrativ”. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të gjykimit të kësaj padie me vendimin gjyqësor nr. 7901 datë 09.07.2013 ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesë padisë”. Aktualisht kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Apelit Tiranë për gjykim, bazuar në ankimin e bërë nga pala paditëse.
- ✓ Çështja me palë paditëse Agron Lamaj, i paditur Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dhe objekt “Shfuqizim vendimi nr. 302 datë 05.07.2013 të K.L.D; konstatimi i diskriminimit i interesave dhe të drejtave themelore dhe detyrimi i palës së paditur të marrë vendim për emërimin tim si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të gjykimit të kësaj padie me vendimin gjyqësor nr. 12030, datë 02.12.2013 ka vendosur: “Kthimin e kërkesë padisë dhe akteve bashkangjitur saj, palës paditëse Agron Lamaj, si padi me të meta”. Aktualisht kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Apelit Tiranë për gjykim, bazuar në ankimin e bërë nga pala paditëse.
- ✓ Çështja me palë paditëse Bujar Musta, i paditur Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dhe objekt “Ndryshim i pikës 18 të vendimit nr 282 dt 16.12.2011 të të paditurit dhe të vendoset vlerësimi “Shumë Mirë” për vitet 2005-2006”. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të gjykimit të kësaj padie me vendimin gjyqësor nr 4112 datë 17.04.2013 ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në

ligj”. Aktualisht kjo çështje ka përfunduar edhe në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë për gjykim, bazuar në ankimin e bërë nga pala paditëse, e cila ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

- ✓ Çështja me palë paditëse Ahmet Jangulli, i paditur Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dhe objekt “Pezullimin e zbatimit të pikës 4 gërma d) të vendimit nr. 304 datë 14.02.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për vlerësimin profesional “Mirë”, mbi projekt aktin përfundimtar të vlerësimit të gjyqtarit për periudhën 2005-2006 etj”. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të gjykimit të kësaj padie me vendimin gjyqësor nr. 4112 datë 17.04.2013 ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj”. Aktualisht kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë për gjykim, bazuar në ankimin e bërë nga pala paditëse.
- ✓ Çështja me palë paditëse Neritan Tabaku, i paditur Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dhe objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 301/2 datë 07.12.2012 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin e tij nga puna”. Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë në përfundim të gjykimit të kësaj padie me vendimin unifikues të datës 12.12.2013 ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Neritan Tabaku si të pabazuar në ligj”.
- ✓ Çështja me palë paditëse gjyqtaren Arjana Lico, i paditur Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dhe objekt “Shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit nr. 326/25 datë 03.05.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mbi vlerësimin përfundimtar “Mirë” të gjyqtarës Arjana Lico për periudhën 2005-2006”. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të gjykimit të kësaj padie me vendimin gjyqësor të datës 30.01.2014 ka vendosur: “Pushimin e gjykimit të kësaj çështje civile” bazuar në kërkesën e paditëses për heqje dorë nga gjykimi.
- ✓ Çështja me palë paditëse Agim Hysi, i paditur Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Rishikim vendimi”. Gjykata e Lartë në përfundim të gjykimit të kësaj kërkesë me vendimin gjyqësor unifikues ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj”.
- ✓ Çështja me palë kërkuese Kudret Kopo, palë e interesuar Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Zyra e Shërbimit Përmbarimor Bailiff Service Albania, dhe objekt “Konstatim i cenimit të parimit për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritet e ngarkuara nga ligji, brenda afatit të arsyeshëm”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje është realizuar nga kryeinspektoria Marsida Xhaferllari e autorizuar nga zëvendëskryetari i KLD-së. Gjykata Kushtetuese në përfundim të gjykimit të kësaj kërkesë me vendimin ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar”.
- ✓ Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, që i përket paditëses Mimoza Margjeka kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Anullimin e vendimit nr 299/4 datë 30.11.2012 të KLD-së me të cilin është vendosur: Dhënia e masës disiplinore Vërejtje me paralajmërim, ndaj znj Mimoza Margjeka, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje u realizua nga inspektori Izet Salaj. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin gjyqësor nr. 53, datë 14.06.2013 ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë. Anullimin e vendimit nr 299/4 datë 30.11.2012 të KLD-së për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” ndaj gjyqtarës Mimoza Margjeka. Aktualisht kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Lartë për gjykim, bazuar në rekursin e bërë nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- ✓ Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, që i përket paditëses Dhurata Bilo kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Anullim i vendimit nr 295/2 datë 05.10.2012 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje u realizua nga inspektori Izet Salaj. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin gjyqësor nr. 14, datë 04.02.2013 ka vendosur: “Rrëzimin e

kërkesë padisë së paditëses Dhurata Bilo”. Aktualisht kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Lartë për gjykim, bazuar në rekursin e bërë nga ana e paditëses.

Këshilli i Lartë të Drejtësisë dhe Presidenti i Republikës, kurdoherë gjatë kësaj periudhe, ka mbështetur të gjithë trupën gjyqësore dhe është treguar gatishmëria për të bashkëpunuar në rritjen e garancive të sigurisë së gjyqtarëve. KLD ka shprehur konsideratën pozitive dhe vlerësimin maksimal për disa nga nismat dhe vendimet e fundit të Qeverisë dhe Parlamentit Shqiptar, për rritjen e nivelit të pagave të gjyqtarëve në Gjykatat e Shkallës së Parë dhe Gjykatat e Apelit dhe për miratimin e ndryshimeve në Kodin Penal.

Merita profesionale dhe morale e gjykatësve dhe jo subjektivizmi i anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kriteret e gjithëdiskutuara dhe të shpallura publikisht dhe jo ndjeshmëria personale e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, procedurat transparente dhe një sistem i listuar vlerësimi janë tashmë parimet me të cilat do të zhvillojmë praktikën e administrimit të karrierës së gjykatësve.

Veprimtaria Komitetit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë në mbështetje të ligjit nr.9109, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit”, i ndryshuar, ka caktuar me vendimin nr.303 datë 18.01.2013 anëtarin e tij, Z. Dritan Hallunaj, si përfaqësues të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në Komitetin Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Në përbërje të këtij Komiteti janë edhe 6 (gjashtë) avokatë të cilët zgjidhen nga Këshillit Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, 1 (një) përfaqësues i Ministrit të Drejtësisë si dhe një përfaqësues nga shoqëria civile. Ky Komitet ka realizuar disa mbledhje duke shqyrtuar deri tani, gjithsej 84 ankesa të propozuar nga Komisioneri i Ankimit i cili është përgjegjës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj avokatit. Nga shqyrtimi i ankesave janë marrë disa vendime të rëndësishme si: Pezullim të Lejes së Ushtrimit të Profesionit, Vërejtje me shkrim për veprime të kryera në kundërshtim me Kodin e Etikës, Kthim i pjesshëm i pagës, Gjjobë, Heqje e të drejtës së ushtrimit të profesionit.

Veprimtaria e Komisioni të Posaçëm për Mbrojtjen e Gjyqtarëve

Sipas vendimit Nr. 480, datë 06.05.2009 të Këshillit të Ministrave, dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit Nr. 9110, datë 24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”, si dhe ligjit Nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” është krijuar Komisioni i Posaçëm për Mbrojtjen e veçantë personale, të familjes dhe të pronës së gjyqtarëve dhe për sigurimin e jetës së tyre.

Ky Komision, referuar parashtrimeve që ka Vendimi i Këshillit të Ministrave, ka në përbërjen e tij një anëtar të Këshillit të Lartë të Drejtësisë me cilësinë e Kryetarit të Komisionit (*sipas vendimit Nr. 302/9, datë 20.12.2012 të Këshillit*). Ndërsa është në përbërje të tij një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, një përfaqësues i Ministrisë së Brendshme, kryetari i gjykatës pranë së cilës ushtron detyrën gjyqtari për të cilin kërkohet mbrojtje, si dhe një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Gjatë vitit 2013, pranë Komisionit kanë ardhur 14 kërkesa nga gjyqtarë, në të cilat kërkohet marrja e masave mbrojtëse për ruajtjen fizike të tyre apo dhe ambienteve të gjykatave. Komisioni, gjatë vitit 2013 është mbledhur 12 herë, me gjithsej 13 vendimmarrje konkrete.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2014 E VIJIM¹

Sot pushteti gjyqësor konsiderohet si një ndër fushat me nivel të lartë të korrupsionit apo dhe të perceptimit të tij nga raportet vlerësuese të organizatave të huaja apo vendase, ankesat e publikut apo denoncimeve të kryera. Pavarësisht faktit se perceptimi i opinionit publik nuk përfaqëson gjithmonë realitetin, një nga detyrat prioritare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është pikërisht përpjekja që ky perceptim të ndryshojë. Në këtë kontekst

Raport progresi ka theksuar se Shqipëria “...duhet të përditësojë strategjinë e reformës gjyqësore dhe të rritë pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënieve institucioneve gjyqësore.”

Edhe Rekomandimet e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Evropës ashtu si dhe Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO) pasi kanë vlerësuar ecurinë e puës në disa aspekte kërkojnë nga Këshilli marrje masash për sa i përket **pavarësisë** dhe **paanshmërisë** së gjyqësorit, **llogaridhënies** në gjyqësor, ashtu dhe për sa i përket **eficencës së gjyqësorit**, duke theksuar këtu dekretin e Presidentit mbi riorganizimin territorial të gjykatave dhe rialokimin e numrit të gjyqtarëve, me propozim të Ministrisë së Drejtësisë dhe pëlqim të Këshillit të Lartë.

Aktualisht siç jeni në dijeni anëtarësimi në Bashkimin Evropian është një nga pikësynimet strategjike dhe objektiv kombëtar për Republikën e Shqipërisë dhe për arritjen e këtij objektiv nevojitet angazhim maksimal dhe përpjekje të vazhdueshme në funksion të demokratizimit dhe transformimit të shoqërisë shqiptare. Prandaj ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, është marrë angazhim për përgatitjen e një “Road Map” për zbatimin e reformave të nevojshme për 5 prioritetet kyçe për procesin e integritetit në Bashkimin Evropian, ku në dy prej tyre, në prioritetin 2 “Reforma në sistemin gjyqësor në shqipëri” dhe prioriteti 3 “Politika antikorrupsion në Shqipëri” Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka një sërë objektivash dhe masash të cilat ajo duhet ti ndërmarrë.

Gjithashtu Këshilli po jep një kontribut të rëndësish dhe në dy dokumenta të tjerë strategjik siç është Strategjia e Kombëtarë e Drejtësisë 2014 – 2020 ashtu si dhe Strategjia Kombëtare Kundër Korrupsionit 2014-2017.

Sfida jonë do të jetë në vazhdimësi, që drejtësia të jetë kudo dhe kurdoherë në dispozicion të qytetarit, që të fitojmë besimin e tij, duke mundur një protagonizëm e monitorim të aktivitetit të gjykatave, si dhe duke garantuar transparencë dhe përgjegjshmëri maksimale në përmbushjen e detyrave tona. Në harmoni me të gjithë dokumentat strategjik të mësipërpër ne do të arrijmë rrisim pritshmërinë e publikut dhe të partnerëve tanë, nëpërmjet objektivave të mëposhtëm të cilat konsistojnë në rritjen e:

- ❖ Eficencës së sistemit gjyqësor, me qëllimin e vetëm që ajo të jetë në funksion të qytetarit, që sistemi të ofrojë drejtësi cilësore, të besueshme për publikun dhe të aksesueshëm për këdo;
- ❖ Luftës së hapur ndaj korrupsionit në të gjithë nivelet ku gjendet, si dhe
- ❖ Pavarësisë së sistemit, nga çdo lloj ndërhyrje, një sistem gjyqësor i varur dhe i përgjegjshëm vetëm nga Kushtetuta dhe ligjet

Dhe e gjithë ky angazhim i yni do të realizohet nëpërmjet masave konkrete për zbatimin e këtyre objektivave dhe konkretisht:

¹ Objektivat miratuar me vendimin qarkullues nr.72 datë 09.06.2014

- ❖ Eficencës së sistemit të gjyqësor, me qëllimin e vetëm që ajo të jetë në funksion të qytetarit, që sistemi të ofrojë drejtësi cilësore, të besueshme për publikun dhe të aksesueshëm për këdo;
- ✚ Rregullimi i organikave në të gjitha gjykatat sipas Dekretit nr. 7818, datë 16.11.2012 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative”, të Presidentit të Republikës;
- ✚ T’i ofrohet Ministrisë së Drejtësisë bashkëpunim për rishikimin nëpërmjet një studimi, i organikave të disa gjykatave, të cilat janë në pamundëi objektive për të ushtruar funksionin e tyre.
- ✚ Ndërmarrja e nisma për reformimin real të sistemit dhe për përmirësimin e tij.
 - Reformim i sistemit të inspektimit nëpërmjet ndryshimeve të ligjit për Këshillin e Lartë të Drejtësisë:
 - ✓ *Qartësimi i kompetencës së inspektoratit që do të ketë të drejtën për të inspektuar gjyqtarët*
 - ✓ *Statusi i inspektorëve*
 - ✓ *Vlerësimi i punës së inspektorëve*
 - ✓ *Përmirësimi i rregullave të inspektimit*
- ✚ Finalizimi i procesit të vlerësimit e etik dhe profesional për të gjithë gjyqtarët për 3 vite, 2007-2008-2009, për afër 50 % të numrit të gjyqtarëve në sistem.
- ✚ Marrja e masave për plotësimin e vendeve vakant në gjykatat administrative qoftë edhe nëpërmjet zhvillimit të një testimi tjetër për kandidatët për këto gjykata;
- ✚ Delegimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore sipas rregullave të reja të miratuara.
- ✚ Rishikimi i vendimit për kriteret dhe mënyrën e delegimit të gjyqtarëve për shqyrtimin e një çështjeje gjyqësore administrative për të siguruar harmonizimin e rregullave me gjykatat e reja administrative.
- ✚ Rishikimi dhe përmirësimi i akteve nënligjore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në periudhën në vazhdim, duke u përqendruar kryesisht tek Sistemi i Pikëzimit për ta përshtatur atë me kriteret më të paqëndrueshme dhe objektive në funksion edhe të Listës së Përhershme të Renditjes së gjyqtarëve.
- ✚ Emërimi në pozicionin e funksionit drejtues në të gjitha gjykatat e vendit konform legjislacionit në fuqi dhe vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- ❖ Luftës së hapur ndaj korrupsionit në të gjithë nivelet ku gjendet;
- ✚ Rritje të mëtejshme garancive për promovimin në karrierë të gjyqtarëve;
- ✚ Rritje të garancive për procedimin disiplinor të gjyqtarëve;
- ✚ Shqyrtimi në një kohë të arësyeshme i të gjitha kërkesave për procedime disiplinore të ardhura në KLD duke vlerësuar mundësinë që në vendimin kuadër të KLD për këtë qëllim të përcaktohet një afat 1 (një) mujor për marrjen në shqyrtim të tyre.
- ✚ Përmirësimin e sistemit të ankesave online dhe vërejtja e mundësive për fillimin e implementimit të inspektimit online;
- ✚ Krijimi i sistemit elektronik për përcaktimin me short të mënyrës së delegimit të gjyqtarëve;
- ❖ Pavarësisë së sistemit, nga çdo lloj ndërhyrje, një sistem gjyqësor i varur dhe i përgjegjshëm vetëm nga Kushtetuta dhe ligjet

- ✚ Marrja e të gjitha masave të domosdoshme për krijimin e infrastrukturës ndihmëse në gjykatat administrative, në mënyrë që të arrihet funksionimi normal i tyre në funksion të dhënies së drejtësisë.
- ✚ Përfundimi i të gjitha inspektimeve të nisuar nga viti 2013, ndjekja nga afër e zbatimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të këtyre raporteve;
- ✚ Përditësimi periodik i listës së përhershme e renditjes së gjyqtarëve, si dhe përditësimi i regjistrit të të dhënave të gjyqtarëve;
- ✚ Vendimmarrje e KLD për krijimin dhe publikimin në faqen zyrtare të KLD të një Liste të gjyqtarëve të cilët pas verifikimeve nga inspektorati, konstatohet se janë me vonese në gjykimin e çështjeve gjyqësore dhe në arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

NË PËRFUNDIM

Këshilli i Lartë i Drejtësisë si institucion që ka një përgjegjësi dhe angazhim të drejtpërdrejtë në organizimin, në kontrollin e funksionimit të sistemit gjyqësor dhe gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, është një nga instrumentet kryesore të rëndësishëm të shtetit, për të analizuar sfidat me të cilat ndeshet sistemi ynë gjyqësor, për të konkluduar për objektivat dhe standardet që duhen arritur, si dhe për të ndërtuar dhe ndjekur atë proces që kërkohet nga vetë Këshilli por kryesisht edhe nga opinioni publik.

Me punën e deritanishme Këshilli ka sfiduar shumë praktika të deritanishme, aspak transparente e të drejta, duke tentuar drejt rritjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, duke tentuar drejt respektit të vetë gjyqtarëve në këtë sistem, ku ato janë protagonistët kryesor.

Këshilli ka bërë maksimumin për të garantuar integritetin profesional dhe njerëzor të çdo gjykatësi të këtij vendi, duke qenë stoik në vendimmarrje, duke mos bërë asnjë promovim apo transferim gjyqtari pa bërë më parë vlerësimin profesional të tyre, proces në fakt i përealizuar nga ky institucion për kaq shumë vite.

Këshilli ka treguar vullnet maksimal për të promovuar vetëm më të mirët e sistemit gjyqësor, pasi çdo transferim apo promovim është realizuar vetëm për ata gjyqtarë të vlerësuar profesionalisht “Shumë mirë”.

Mirëfunksionimi i ndarjes së pushteteve, kontrolli dhe balanca, janë themeli i një shteti të së drejtës dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë do të bëjë gjithçka që gjyqtarët të garantojnë një gjë të tillë, nëpërmjet vendimmarrjeve të tyre, transparente dhe të përgjegjshme.

ZËVENDËSKRYETARI

ELVIS ÇEFA

Sekretari i Përgjithshëm: P. Prendi

Drejtorja e Administratës dhe Financës: Xh. Haxhiu

Drejtorja Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit: V. Kaloshi

18



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Bulevardi "Zog I", Tiranë.

Tel: +355 4 2259817, Fax: +355 4 2259822

www.kld.al

LISTA E GJYQTARËVE SI DHE VENDIMET E KLD-SË PËR LEJET E MËSIMDHËNIES VITI 2013

| Nr | Gjyqtari | Data dhe numri i vendimit | Universiteti |
|-----|--|-------------------------------------|---|
| 1. | LAURENT FUÇIA Gjykata e Rrethit Vlorë | Vendimi nr. 321, datë 03.05.2013 | Universiteti Jopublik "Albanian University", Dega Berat dhe Fier |
| 2. | ANDRI YMERI Gjykata e Rrethit Shkodër | Vendimi nr. 322, datë 03.05.2013 | Universiteti Jopublik "Argenti", Shkodër |
| 3. | FUAT VJERDHA Gjykata e Apelit Shkodër | Vendim Nr. 365, datë 18.09.2013 | Kolegjit Profesional "Argenti" (Fakulteti i Drejtësisë, dega juridik), Shkodër |
| 4. | ASTRIT KALAJA Gjykata e Apelit Shkodër | Vendim Nr. 366, datë 18.09.2013 | Kolegjit Profesional "Argenti" (Fakulteti i Drejtësisë, dega juridik), Shkodër |
| 5. | ILIR MUSTAJ Gjykata e Rrethit Tiranë | Vendim Nr. 367, datë 18.09.2013 | Shkollës së Magjistraturës, Tiranë Fakultetit Ekonomik, Universiteti i Tiranës; Universitetit "Justiniani I", Tiranë. |
| 6. | HYSNI DEMIRAJ Gjykata e Apelit Tiranë | Vendim Nr. 395, datë 28.10.2013 | Universitetit privat/Fakultetit jopublik "Akademia e Biznesit" Tiranë |
| 7. | KLODIAN KURUSHI Gjykata e Krimeve te Renda | Vendim Nr. 396, datë 28.10.2013 | Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. |
| 8. | LUAN HASNEZIRI Gjykata e Krimeve te Renda | Vendim Nr. 397, datë 28.10.2013 | Institucionit të Arsimit të Lartë Jopublik "Albania University" dhe "Akademia e Biznesit". |
| 9. | SOKOL NGRESI Gjykata e Apelit Vlore | Vendim Nr. 398, datë 28.10.2013 | Universitetit Jopublik "PAVARËSIA" në Vlorë dhe në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin Shtetëror Tiranë. |
| 10. | ERJON BANI Gjykata e Rrethit Tiranë Stazh prof | Vendim Nr. 399, datë 28.10.2013 | Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe Universitetit Jopublik "Kristal" Dega Farmaci. |
| 11. | FIQIRETE MULLAJ Gjykata e Apelit Tiranë | Vendim Nr. 426, datë 20.12.2013 | Universitetit jopublik "Akademia e Biznesit" Tiranë. |

| | | | |
|------------|--|------------------------------------|--|
| 12. | NURJETA TAF Gjykata e Rrethit Tiranë Stazh prof | Vendim Nr. 425, datë 20.12.2013 | Universitetit Jopublik "Albanian University" Tiranë. |
| 13. | GENTI DOKOLLARI Gjykata e Rrethit Tiranë Stazh prof | Vendim Nr. 423, datë 20.12.2013 | Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe Universitetit Jopublik "Albanian University" filiali Tiranë dhe filiali Berat |
| 14. | REZARTA MATAJ Gjykata e Rrethit Tiranë | Vendim Nr. 424, datë 20.12.2013 | Universitetit Jopublik "Luarasi" Tiranë |
| 15. | FATRI ISLAMAJ Gjykata e Rrethit Tiranë | Vendim Nr. 428, datë 20.12.2013 | Universitetit Jopublik "BEDER" Tiranë |
| 16. | AMARILDO LAÇI Gjykata e Apelit Krimet e Renda | Vendim Nr. 427, datë 20.12.2013 | Shkollës së Magjistraturës, Universitetit Jopublik "Albanian University" |